



Bruksel/Stamboll, 1 Qershor 2009

## **Ballkani dhe Lista e Bardhë e Shengenit - propozim për rrugën më tej**

Të dashur Miq,

Në javët dhe muajt në vazhdim Komisioni Evropian dhe shtetet anëtare të BE-së do të vendosin se cilat vende të Ballkanit Perëndimor do të kualifikohen për heqjen e vizave të Shengenit. Vendimi i BE-së mund të rivendosë besueshmërinë e BE-së dhe pushtetin e saj të butë në rajon. Ky vendim mund të balancojë shpresat e njerëzve në Ballkan me shqetësimet e atyre që janë përgjegjës për mbrojtjen e zonës së Shengenit ndaj migracionit të paligjshëm dhe krimit të organizuar.

Nga njëra anë ekzistojnë pritshmëri të mëdha nga ana e qeverive dhe qytetarëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kërkesa për viza gjithmonë ka sjellë frustrim, duke sjellë kështu dyshimin nëse perspektiva Evropiane e Ballkanit Perëndimor është reale. Në këtë moment janë rishfaqur sërish shpresa dhe entuziazmi për këtë çështje.

Nga ana tjetër qeveritë e vendeve të BE-së kanë theksuar rëndësinë për të siguruar qytetarët skeptik të BE-së që ata do t'i shqyrtojnë në mënyrë të drejtë por me kushtëzime strikte faktet për heqjen e vizave për Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. Kushtet janë përshkruar në udhërrëfyesin për një regjim pa viza, dokument i cili është lëshuar vitin e kaluar.

Bazuar në çka është arritur deri më tani (përshpejtimi i përpjekjeve për reforma në Ballkanin Perëndimor, vizitat e shumta në rajon nga ekspertët e BE-së, dhe analizat e hollësishme të progresit nga Komisioni Evropian), në fakt është e mundur të adresohen të dy shqetësimet në të njëjtën kohë - të jenë striktë dhe të drejtë.

Ne ofrojmë zgjidhjet e mëposhtme për shqyrtim:

### **Maqedonia**

Vlerësimet e Komisionit dhe raportet e ekspertëve nuk lënë dyshim se Maqedonia duhet të fitojë të drejtën e udhëtimit pa viza sa më shpejt të jetë e mundur, pra maksimumi duke filluar nga Janari i vitit 2010. Një vendim i tillë do të dërgonte një sinjal të fuqishëm në rajon që kushtëzimi është marrë seriozisht, dhe se reformat janë shpërblyer.

Pavarësisht nga zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit Evropian dhe ngritjes së Komisionit, parashikuar për në Nëntor, institucionet e BE-së duhet të sigurojnë që vendimi për ndryshimin e Rregullores së Këshillit 539/2001 të merret sa më shpejt.

Komisioni duhet të bëjë propozimin e nevojshëm legjislativ brenda javëve në vazhdim, në mënyrë që maqedonasit të udhëtojnë pa viza duke filluar nga Janari i ardhshëm. Parlamenti i ri Evropian duhet ta trajtojë me përparësi këtë dosje pas përfundimit të verës, në mënyrë që Këshilli të mund të votojë për këtë çështje në vjeshtë.

### **Mali i Zi dhe Serbia**

Mali i Zi dhe Serbia kanë ende disa kushte për të përmbushur. Megjithatë, sipas përfundimit të Komisionit, edhe në fushat ku të dy vendet ende nuk kanë arritur të zbatojnë plotësisht standardet, "një shumicë e madhe" ose " shumica e kritereve" janë përmbushur.

Duke pasur parasysh se Këshilli do të votojë për heqjen e vizave brenda pesë muajve në rastin më të parë (në Këshillin e 23 Tetorit të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme), ndoshta edhe më vonë (në Këshillin e fundit të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme më 30 Nëntor / 1 Dhjetor 2009), këshillohet që Komisioni në propozimin e ardhshëm të përfshijë heqjen e vizave për Malin e Zi dhe Serbinë, ndërkohë që duhet t'ua bëjë të qartë se ky është një kushtëzim për reforma të mëtejshme.

Pesë ose më tepër muajt e ardhshëm do të jenë të mjaftueshëm për të vlerësuar nëse këto dy vende po bëjnë përpjekje serioze lidhur me përmbushjen e kërkesave të pazgjidhura. Nëse do të ketë sërish dyshime, Këshilli mund të ftojë Komisionin për të kryer një vlerësim përfundimtar përpara se të vendosë.

### **Kosova**

Komisioni dhe shtetet anëtare duhet t'i përmbahen kërkesës që Serbia t'u mundësojë banorëve të Kosovës marrjen e pasaportave serbe. Një prej kushteve të planit për Serbinë thotë qartë:

"Serbia duhet të sigurojë qasje të plotë dhe efektive për dokumentet e udhëtimit dhe të identifikimit për të gjithë qytetarët serbë duke përfshirë gratë, fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara, njerëzit që u përkasin pakicave dhe grupeve të tjera të pambrojtura."

Për sa kohë qeveritë Serbe pretendojnë, dhe disa vende anëtare të BE-së pranojnë se kosovarët janë qytetarë serbë (pavarësisht nga përkatësia etnike), çdo diskriminim i hapur ose i fshehur do të jetë një shkelje e parimit të mosdiskriminimit.

BE-ja është e justifikuar kur kërkon siguri në këtë proces, në mënyrë të veçantë për sa i përket regjistrave civilë dhe dokumentave të thjeshtë që janë përdorur. Por Serbia nuk duhet ta kthejë

procesin në diskriminues. Për sa kohë që BE-ja nuk i ofron Kosovës një udhërrëfyes për regjim pa viza apo ndonjë proces tjetër që çon drejt heqjes së vizave, në këtë formë ajo pranon që kosovarët janë qytetarë serbë. Kjo do të thotë se kosovarët kanë të drejtë të marrin dokumente udhëtimi dhe identifikimi serbe.

### **Shqipëria dhe Bosnje-Hercegovina**

Shqipëria dhe Bosnje-Hercegovina dukshëm kanë më shumë punë për të bërë para se të kualifikohen për udhëtimin pa viza. Duke qënë strikt është po aq thelbësore për suksesin sa ç'është edhe të qenit i drejtë.

Pyetja tashmë është se si të sigurohen që të dy vendet të ndërmarrin reformat e nevojshme, të cilat Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi tashmë i kanë arritur.

Do të ishte kundër-produktive që ato të përjashtohen nga procesi i filluar. Duke parë Serbinë që ecën përpara, ky fakt mund të rezultojë destabilizues për Bosnjen - shumica e kroatëve të Bosnjes përdorin pasaporta kroate, të cilët lejojnë udhëtimin pa viza, si dhe një numër i konsiderueshëm i serbëve të Bosnjes kanë marrë ose janë në procesin e marrjes të shtetësisë serbe dhe të pasaportave serbe. Kjo do të veçojë boshnjakët si të vetmin komunitet të cilit do t'u nevojiten viza. Qeveria e re Shqiptare e cila do të dalë nga zgjedhjet në fund të Qershorit, gjithashtu ka nevojë për një perspektivë konkrete. Prandaj këshillohet që këtyre dy vendeve t'u ofrohet një kalendar i ri.


Alternativa më e mirë do të ishte të dy vendet të përfshihen në propozimin e ardhshëm për të ndryshuar Rregulloren e Këshillit 539/2001, duke i lëvizur ato në listën e "bardhë" të Shengenit - por duke bërë këtë, të përcaktohet se udhëtimi pa viza për Shqipërinë dhe Bosnjen të mbeten në pritje deri sa të gjitha kushtet e udhërrëfyesit të jenë plotësuar. Propozimi duhet të përfshijë edhe një datë specifike për një vlerësim të ri që do të kryhet nga Komisioni dhe ekspertët e shteteve të BE-së në fillim të vitit 2010.

Në të njëjtën kohë Këshilli duhet të vazhdojë të komunikojë qartë se do të marrë vendimet e tij bazuar në kriteret teknike, jo politike - dhe se në proces nuk do të ketë vend për diskriminim apo anashkalime.

Tashmë kuptohet se duke i shprehur qartë kushtet për një regjim pa viza ka frymëzuar reforma në të gjithë rajonin, çka e ka bërë më të sigurtë si vetë rajonin, ashtu edhe BE-në. Një vendim i Këshillit që përfshin të pesë vendet - duke shënuar përparimin e tyre deri më sot - do të sigurojë vazhdimësinë e procesit.

ESI i është mirënjohës Robert Bosch Stiftung për mbështetjen që i ka dhënë për "ESI Schengen White List Project".

Gjitha të Mirat nga



Gerald Knaus,  
President i ESI



Alexandra Stiglmaier,  
Drejtoreshë e "ESI Schengen White List Project"

## **Lexime të mëtejshme rreth projektit „Lista e Bardhë e Shengenit” nga ESI:**

- [About the Schengen White List Project](#)
- [Strict but fair – The Declaration](#)
- [Stories from the Balkan ghetto](#)
- [The road to visa-free travel](#)
- [The visa facilitation and readmission agreements](#)
- [The visa roadmaps](#)
- [Visa roadmap A to Z \(glossary\)](#)
- [The readiness reports](#)
- [Assessments by the European Commission](#)
- [EU timetable](#)
- [Letters from EU foreign ministers](#)
- [Excerpts from EU policy documents](#)
- [Chronology](#)
- [Interviews](#)
- [Media reactions](#)
- [Recommended reading and watching](#)

### **Kontakt:**

European Stability Initiative (ESI)  
Grossbeerenstrasse 83  
10963 Berlin  
Deutschland

Tel: +49 30 53214455  
Fax: +49 30 53214457  
Email: [info@esiweb.org](mailto:info@esiweb.org)  
Website: [www.esiweb.org](http://www.esiweb.org)

© European Stability Initiative (ESI)